

NDRIÇIM MEHMETI

**SITUATA POLITIKE NË SHQIPËRI
NË PRANVERËN E VITIT 1914**

**Gjendja në Shqipërinë e Mesme
në prag të rebelimit**

Ngjarjet e pranverës së vitit 1914, të njohura ndryshe, si kryengritja e Shqipërisë së Mesme, kanë qenë edhe më parë objekt studimi. Të nxitur fillimisht nga pakënaqësia, se Vidi, me të drejtë duhej ta trajtonte më mirë problemin e fshatarësisë, ajo e shndërrua në lëvizje të dhunshme dhe me tipare të qarta politike. Ndonëse u mendua se kjo lëvizje u drejtua kundër Princit të krishterë, në vetvete ajo u drejtua kundër Shqipërisë. Por edhe nëse tentohet të shpjegohet me luftën kundër bejlerëve dhe imperializmit të Fuqive të Mëdha, kjo është më pak e besueshme. Niveli politik i shqiptarëve, në kohën kur u zhvillua kjo lëvizje dhe i fshatarësisë në veçanti, nuk lë shumë vend për këtë argument. Sidoqoftë, ky parashtrim përpiket të sjellë një këndvështrim të ri të mbështetur në burime të reja, të cilat hedhin poshtë idenë se kjo ishte një lëvizje popullore dhe përparimtare. Në prag të shpërthimit të kryengritjes së Shqipërisë së Mesme, shoqëria shqiptare, ndahej në disa grupime.

Grupimi i parë përbëhej nga klasa e bejlerëve përparimtar, nacionalistëve intelektual dhe shtresa e re, por e dobët e borgjezisë, e cila, kishte ushqyer shpresa të mëdha tek i dërguari i Europës për t'i dhënë një fytyrë të re vendit të saj. Prandaj “*vetëm bejlerët të cilët ishin të bindur që duhej medoemos një Princ i krishterë, ashtu edhe intelektualët që ishin të zotë të çmonin situatën, vrapuan dhe i bënë nënshtrimin me gjithë zemër*”¹. Princi i ri shihej si simboli i evropianizimit të vendit dhe si

¹ Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), Fondi A-IV-66, S. bej Vlora, *Kujtime*, fl.10.

mundësia historike për t'u ndarë një herë e përgjithmonë nga administrimi i vjetër gjysëm mesjetar.

Një grupim tjetër i cili që pas 17 Majit 1914 luajti rolin më të rëndësishëm në jetën e vendit ishte fshatarësia. Ky grupim ishte heterogjen për nga përbërja dhe kërkesat e tyre gjatë rebelimit kundra tij. Fshatarësia, e cila përbënte në Shqipëri pjesën më të madhe të popullsisë, shpresonte në përmirësimin e gjendjes së saj nga qeveria e Vidit. Kjo shtresë sociale ishte ndoshta pjesa më e vuajtur e popullsisë, mbi kurrizin e së cilës vepronin taksat, sëmundjet epidemike stinore etj. Por pyetja është: A ishte fshatarësia kaq e ndërgjegjësuar për të drejtat e saj? Kjo është një analizë, e cila mund të nxjerr në pah sesi kjo ndjesi e drejtë e fshatarësisë u manipulua në mënyrën më të keqe të mundshme.

Grupimi i fundit i cili përpiquej të përfitonte nga dy të parët (mbase më shumë nga fshatarësia) ishin përfaqësuesit e vjetër të pushtetit osman. Me ardhjen e Princit të ri, ata e gjetën veten të përjashtuar dhe mbase në pamundësi për t'u përshtatur me pushtetin e tij. Ata kishin mundur të siguronin privilegje të mëdha jo vetëm nga ofiqet zyrtare, por edhe nga sigurimi i pronave tokësore, të cilat trashëgoheshin brez pas brezi. Deri në këtë periudhë, ky grupim kishte në dorë fuqinë ekonomike dhe politike. Parë nga ky këndvështrim, kjo shtresë ishte e gatshme për të bërë gjithçka, me qëllim për të zgjatur sa më shumë të ishte e mundur pushtetin e tyre.

Në këtë analizë të situatës kishte vend për të kundërshtuar, por kritika ndaj qeverisë dhe Vidit asnjëherë nuk u bë e tillë. Në vend të saj, gjithçka iu drejtua aksionit të fshehtë, komplotit, kërcënimit dhe më në fund kur të konsumoheshin të gjitha, armët do të zëvendësonin gjithçka për të justifikuar kërkesat e të pakënaqurve. Përveç këtyre grupimeve, Durrësi u bë arena e luftës së spiunazhit dhe rivalitetit evropian. Nëse austro-hungarezët dhe italianët ishin në rivalitet për vendosjen e kontrollit të tyre, është e tepërt të thuhet se ndoshta pa e kuptuar dhe vetë, ato ndërtuan një politikë për të shkatërruar shtetin e ri shqiptar. *“Ndërkohë që rivaliteti dhe interesat politike diktonin të gjitha masat e pasinqerta për t'ia bërë jetën të pamundur Shqipërisë, nga ana tjetër ishte nisur një fushatë shtypi kundër saj”*². Përkundër kësaj Greqia, Serbia dhe xhonturqit ishin më të interesuara, për destabilitet.

² Mit'hat Frashëri, *L'Indipendance Albanaise*, “Nëntori 1912”, viti 1, nr.12, 1 gusht 1915.

Destabiliteti do të thoshte më shumë territore jashtë administrimit të qeverisë shqiptare, dhe për rrjedhojë mundësi për zgjerim territorësh nga Serbia dhe Greqia. Xhonturqit nga ana e vet kërkonin të vinin në jetë një plan jo të panjohur për fuqitë evropiane për një territor të supozuar mysliman (Shqipëria e Mesme), që do të kishte dëshirën të ishte në varësi të Turqisë. Brenda një kohe të shkurtër, gjendja në Durrës u ndërlikua më shumë nga ç'ka mund të dukej në të vërtetë. “*Turhan Pasha u nis për në Evropë për të rregulluar tre gjëra: Kërkimin e ndihmës së Fuqive të Mëdha për zgjidhjen e shpejtë dhe të volitshme për Shqipërinë të çështjes epiriote, rregullimin e çështjes së huas prej 75 milion dhe njohjen e titullit mbret Vidit nga ana e Fuqive të Mëdha*”³.

Nga njëra anë qeveria që po përpiquej të mbahej në këmbë dhe të rriste dinjitetin e saj, përmes mbështetjes financiare e politike nga Fuqitë e Mëdha, dhe nga ana tjetër trazirat që kishin filluar të bëheshin edhe më kërcënuese për qeverinë dhe Vidin. Tashmë Vidit dhe qeverisë së tij do t'i duhej të luftonte në tre fronte: Zgjidhja e problemit të Shqipërisë së Jugut; çështjet e brendshme financiare dhe së fundi, përballimi i pakënaqësisë që sa vinte bëhej më shqetësuese. Ndërkaq princi e pa të udhës që nëpërmjet KNK-së, të mund të zgjidhte paqësisht çështjen epiriote, kur aksioni ushtarak dështoi dhe nuk nxorri gjë në dritë. Nëpërmjet një turi diplomatik të kryeministrit të tij në Evropë, Turhan Pashës, ai shpresoi të siguronte mbështetjen e shumëpritur financiare, si dhe të riafirmonte mbështetjen politike të Evropës. Shpresat e Vidit filluan të ktheheshin në iluzione. Raportet e diplomatëve në Durrës jepnin një pamje gjithnjë e më të pashpresë. “*Këtu e shikojnë me pesimizëm të jashtëzakonshëm çështjen e Shqipërisë. Edhe përfaqësuesit e Fuqive më të interesuara duken të dëshpëruar për sa i përket ekzistencës së Shqipërisë. N.q.s. bëhet ndarja, Bullgaria duhet të marrë kompesim*”⁴. Për ngjarjet e majit të vitit 1914 të përkufizuara si kryengritja e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme është shkruajtur parë edhe nga këndvështrime të ndryshme. Ajo që merr një rëndësi në këtë trajtesë është: se cila ishte shtypa e vërtetë e këtyre ngjarjeve? Fatkeqësisht kronika e ngjarjeve që do të mundohemi të sjellim në këtë shtjellim, tregon se shumë pak herë kjo lëvizje i shërbeu çështjes ekonomike të

³ *AIH*, A-IV-271, Dokumente të Ambasadës Bullgare në Vjenë, fl.39. Telegram i konsullit Pavllov drejtuar Ministrit të Jashtëm, 5 maj 1914.

⁴ *Po aty*, Fondi A-IV-27, fl. 44. Legata Mbretërore në Londër-Ministrisë së Jashtme të Bullgarisë, dt. 13 maj 1914.

fshatarësisë. Lëvizja e fshatarësisë përfshiu shtresa e grupime, të cilat, jo vetëm që nuk kishin asgjë të përbashkët me interesat e fshatarësisë, por e shfrytëzuan atë për interesat e tyre politike.

Si në gjithë zhvillimin e ngjarjeve deri në atë kohë dhe në ato të majit 1914, Esat Pashë Toptani, ishte figura rreth të cilit u fol dhe u hodhën akuzat më të forta. Por duket se fillimisht ishte ai që qetësoi Mbretin dhe qeverinë, për fjalët e përhapura për një lëvizje kundër qeverisë. “*Esat Pasha u nis për të vizituar krahinat e prekura - Shijakun, Tiranën, Kavajën etj. - dhe pas pak ditësh u kthye në qendër. Ai raportoi se lëvizja nuk ishte serioze dhe ishte shkaktuar nga veprimet pa takt të disa oficerëve me rang të ulët dhe e siguroi Mbretin se ai kishte vendosur çdo gjë në rregull*”⁵. Por Armstrong hedh dyshimin se “*ai (Esati-N.M) në mënyrë të qëllishme mund t’i ketë bërë një raport të rremë zotërisë së tij mbretëror, për disa arsye që vetëm ai i dinte*”⁶. Nga ana tjetër, Princi mund të ketë besuar plotësisht tek Esati, pavarësisht se ai kërkoi informacion të mëtejshëm prej oficerëve austro-hungarezë dhe hollandez në terren. Gjithësesi dyshimet e para për Esatin, me ose pa të drejtë, tashmë kishin lindur. Ndërsa ngjarjet në Shqipërinë e Mesme po e çonin vendin drejt destabilitetit, një goditje tjetër për nacionalistët shqiptar ishte “Protokolli i Korfuzit” i datës 17 maj 1914. “*Me anë të kushteve të këtij protokollit, Epiri i Veriut arriti autonominë duke patur si prijës Vidin pa ndonjë pushtet esencial*”⁷. Ditën e nënshkrimit të “Protokollit të Korfuzit” si një rastësi e hidhur mbërritën lajmet e para për shpërthimin e një lëvizjeje në Shijak. Fillimisht u duk se kjo lëvizje mund të shuhej shpejt, bile edhe vetë Esati dukej më i interesuar për këtë. Por ajo nuk qe kaq e parëndësishme, siç u paraqit në fillimet e saj, si një “*kërkesë kundër shërbimit ushtarak*”⁸ apo “*kundër reaksionit feudal, princit të huaj dhe pushtuesve shovinistë*”⁹, por më e komplikuar se kaq. Padyshim kryengritja ka patur një dorë që e ka përgatitur me kujdes, e ka armatosur dhe më në fund e ka ndërsyer kundër Vidit e qeverisë. Esati i kishte qetësuar mbështetësit tij duke i thënë se “*Unë nuk e kam harruar premtimin tim, vazhdoj të jem me ju por pres çastin e duhur për të bërë*

⁵ Heaton D. Armstrong, *Gjashtë muaj Mbretëri*, Tiranë, 1995, f.43.

⁶ *Po aty*, f.43.

⁷ AIH, Fondi A-IV-63, Vasil Kondis, *Bibliografia ballkanike*, fl.118.

⁸ F. Salleo, *Shqipëria: gjashtë muaj mbretëri*, Tiranë, 2001, f.81.

⁹ Gazmend Shpuza, *Aspekte të mendimit politik-shoqëror shqiptar (1913-1915)*, Tiranë, 1990, f.73.

ndonjë gjë kundër 7 kralave”¹⁰. T. Selenica thekson se: “Esadi si diktator fuqiptotë në kabineti e Turhan Pashës, po zhvillonte propagandën e tij lirisht; shokve e bashkëpuntorëve të djeshëm kundër I.Qemalit q’ë pyesnin se “qysh e kishim fjalën” u përgjigjesh: “Unë prapë n’atë fjalë jam, po pres kohën”¹¹. Që në fillim kryengritësit kishin kërkesa që shkonin shumë larg interesave ekonomike. “Zotni: siç po dëgjojmë, sot do të vijkan këtu një shumicë e madhe katundarësh thjeshtë popullore u shfaq në një ngjyrë vetëm shoqnore: një kryengritje burgeze-katundare kundër klasës ë bejlerëve”¹². Duke analizuar situatën, Syrja bej Vlora jep këtë opinion: “Çështja nëse gjykohet sipas rrjedhës së ngjarjeve kuptohet që burimi i kryengritjes ish në Legatën Italiane, komanda e rebelëve ishte në dorën e baron Aliottit.”¹³ Në të kundërt të Vlorës, Indro Montanelit mendon se: “Rebelizmi u ndez sërish nga partizanët e Esatit të ngjuar në Tiranë”¹⁴. Amstrong, i cili “shkoi në mëngjesin e 18 Majit në Shijak” deklaroi se ai “ndihej i kënaqur që Esati nuk ishte udhëheqës i tyre (kryengritësve-N.M), përveç kësaj dukej se revolta nuk ishte drejtuar kundër Mbretit si person, por kundër ministrave të tij. Dy ishin shkaqet kryesore: fanatizmi fetar dhe pakënaqësia agrare.”¹⁵ Ndërkaq S.Vllamasi ka mendimin se: “Esati e nxiti popullin e Shqipërisë së Mesme për kryengritje kundër Vidit me qëllim që të bëhej kryetar i shtetit”¹⁶. Fischer në analizën që i bën ngjarjeve arrin në përfundimin se: “Popullsia myslimane ishte e pakënaqur prej pranisë së një princi të krishterë. Nga ana tjetër mbështetja që i jepte ai pronarëve të mëdhenj konservatorë të tokave kishte larguar prej tij masën e fshatarësisë.”¹⁷

Koha tregoi që kjo lëvizje në zhvillimin e saj nuk u motivua vetëm nga kërkesa agrare, por ata që e shfrytëzuan i dhanë drejtimin që dëshironin. Të gjitha arsyetimet, analizat dhe dëshmitë e kohës e vënë Esatin në krye të kësaj pune, por jo vetëm kaq. Ka shumë mundësi që në

¹⁰ Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1912-1925)*, Tiranë, 2001, f.71.

¹¹ Teki Selenica, *Shqipëria në vitin 1927*, Tiranë, 1928, f.37.

¹² Mustafa Kruja, *Antologji historike*, Tiranë, 2001, f. 282.

¹³ AIH, Fondi A-IV-61, Syrja bej Vlora, *Kujtime*, fl. 83.

¹⁴ I. Montaneli, *Shteti i ri shqiptar dhe fronti i Princ Vidit* (përkthim i A. Plasarit), “Albania”, 04.07.2004, f.16-17.

¹⁵ H. D. Amstrong, *vep. e përm.*, f. 48.

¹⁶ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri*, Tiranë, 1995, f. 65.

¹⁷ Bernd Fischer, *Përpyjekjet e mbretit Zog për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, 2000, fq 20.

gjirin e kryengritësve kishte element, të cilët nuk kontrolloheshin nga Esati. Ata i bashkonte vetëm çështja e përbashkët: rrëzimi i Vidit dhe zëvendësimi i pushtetit të tij me një princ mysliman. Në këto rrethana intrigash, lëvizja rrebele shpërtheu dhe Esati vazhdonte ta quante si një shqetësim pa baza. *“Ai u dërgua në terren, por vazhdonte ta paraqeste gjendjen rozë”*¹⁸. Në këtë konfuzion mendimesh dhe vështirësish për të marrë vendimet e duhura, vjen incidenti me Esatin. Nga një çështje e brendshme, ajo u kthye në një çështje ndërkombëtare. Incidenti me Esatin ishte jo vetëm një përplasje institucionale mes Vidit dhe njërit prej ministrave të tij, por ishte edhe një ngatërresë kompetencash të brendshme e përzier me ndërhyrjen e diplomatëve italian e austro-hungarezë. Arrestimi ishte një përpjekje e sforcuar e Vidit për të ndëshkuar Esatin. Kjo lëvizje e princit u komentua edhe si një goditje kundër Italisë. Kryeministri italian pranon afrimin e Esatit me Italinë. *“Roma u afrua me Esat Pashë Toptanin, i cili tregojë “mik i Italisë” ka shkruajtur kryeministri italian i atëhershëm Salandro”*.¹⁹ Një ditë para shpërthimit të Kryengritjes së Shqipërisë së Mesme dhe dy ditë para incidentit dhe arrestimit të Esatit, konsulli i Bullgarisë, njofton Ministrin e tij të Jashtëm për një vizitë që i kishte bërë kapiten Castoldi. *“Zoti kapiten nuk e fshehu se gjendjen në Shqipëri e konsideronte jashtëzakonisht të ndërlikuar”*²⁰. Më tej konsulli jep edhe opinionin e kapitenit për shkaqet e kësaj gjendje: *“Shkaqet: Çështja e Epirit, veprimet e Serbisë në Dibër dhe kryesisht intrigat e diplomacisë austriake, e cila me anën e agjentëve të saj, përpiket në çdo mënyrë të minojë ndikimin dhe autoritetin e Esat Pashës”*.²¹

Fillimi i rebelimit dhe arrestimi i Esat Pashë Toptanit

Incidenti me Esatin, për nga mënyra sesi u zhvilluan ngjarjet dhe arrestimi i tij linte shumë për të dëshiruar. Fillimisht, ngjarja u raportua *“si një rivalitet mes majorit Sluys dhe Esatit. Sluys e bindi Princin për të*

¹⁸ H. D. Armstrong. *vep. e përm.*, f. 49.

¹⁹ Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare*, Tiranë, 1987, f. 87.

²⁰ AIH, Fondi A-IV-271, Dokumente të Ambasadës Bullgare në Vjenë; Fondi A-IV-271, fl.39, 51.

²¹ *Po aty.*

arrestuar Esatin si tradhëtar".²² Sipas Amstrong "princi vendosi të mbështes Sluys".²³ Ndërsa vëzhgues të politikës shqiptare vërejnë se: "Esat Pasha në vend që të arrestohej natën dhe pranë të shoqes së tij dhe në vend që të vihej në rrezik një shumicë populli, mund të arrestohej ditën në zyrën e tij."²⁴ Sido që të ishin dyshimet për Esatin, ai ndoshta nuk meritonte një veprim kaq të nxituar dhe një aksion kaq të vendosur ushtarak, që krijoi një pështjellim të madh në gjykimin e drejtë të ngjarjes. Për më tepër Esati ishte Ministër i Luftës dhe i Brendshëm dhe së paku në aspektin institucional ai mund të ishte trajtuar ndryshe. Vidi i kishte të gjitha kompetencat për ta thirrur Ministrin e tij dhe në përputhje me Statusin Organik të bënte të njohur shkarkimin e tij, në bazë të provave të pretenduara për komplot kundra shtetit. Vidi u mbështet tek opinioni i oficerëve hollandez dhe austro-hungareze, për ndëshkimin e Esatit. "Gjithë ndodhimet shpinin në një grusht shteti të paramenduar, tradhëtar të Esatit. Prova me shkrim të çfarëdolloi qoftë nuk u gjenden dhe as nuk mund të gjendeshin, pse Esadi nuk dinte të lexonte".²⁵ U mendua se në rast se arrestohej Esati, situata do të qetësohej, por ngjarjet shkuan në këtë pikë edhe vetë Vidi humbi një shans të mirë vendosmërie dhe u lëkund shumë në vendimet e tij. "Fillimisht Mbreti urdhëroi që Esati të dërgohej në bordin e anijes "Szigetvar. Me ndërhyrjen e të huajve, Mbreti ndryshoi mendje dhe mendoi ta çoj Esatin në burg, por edhe pas, ndërhyrjeve të shumta, u zbatua urdhëri i parë".²⁶ Ky qëndrim hidhëroi nacionalistët dhe të gjithë ata që nuk e kishin mirëpritur ngritjen e Esatit në poste kaq të larta. Nga ana tjetër ai nxiti përkrahësit e Esatit dhe ka mundësi edhe italianët ta shikonin këtë si një hakmarrje personale. "Në Durrës mbretronte deziluzioni sesi Esadi u la i lirë."²⁷ Në qarqet politike italiane incidenti shkaktoi një pështjellim. Ministri i Jashtëm i Italisë, San Guliano u thirr në parlament për të dhënë shpjegime për ngjarjen. "San Guliano do të deklaronte në parlament se nuk kishte të dhëna rreth ngjarjes, gjë që ngjalli një pakënaqësi të madhe sa shtypi do të këmbëngulte për një dorëheqje të mundëshme".²⁸ Megjithatë, Salleo ka

²² F. Salleo, *vep. e përm.*, f. 82.

²³ H. D. Amstrong, *vep. e përm.*, f.51.

²⁴ AIH, Fondi A-IV-61, S. bej Vlora, *bur. i cit.*, fl.25.

²⁵ *Po aty*, Fondi A-IV-66, Vilhelm Vidi, *bur. i cit.*, fl.13.

²⁶ H. D. Amstrong, *vep. e përm.*, fq.54.

²⁷ AIH, Fondi A-IV-66, *bur. i cit.*, fl.14.

²⁸ F. Salleo, *vep. e përm.*, f. 84.

një mendim shumë të qartë për këtë situatë. “Princi ishte në dilemë për ta nxjerr në gjyq (Esatin-N.M.) apo të zgjidhte atë rrugë që zgjodhi, e cila tregoi dobësi, pasojat e të cilës zor se do të ndreqeshin më pas.”²⁹

Italianët duhet të ishin më të interesuar që Esati të dëbohej dhe jo të nxirrej në gjyq. “Ata morën përsipër mikëpritjen e Esatit, që më shumë i ngjante pritjes së Esatit -ministër sesa Esatit të dëbuar si komplotist kundër shtetit.”³⁰ Vendi i lënë bosh në qeveri duhej të zëvendësohej nga një njeri, i cili duhet të kishte ndikim në Shqipërinë e Mesme. Që të gjeje njerëzit e duhur për të marrë një barrë kaq të rëndë, në një moment tepër delikat ishte një punë mjaft e vështirë. Ndërsa Vidit duket se i kishte ikur situata nga duart, oficerët në terren nuk ishin të qartë për masat që duheshin marrë. “Në 21 Maj lajme të këqija vinin nga Kavaja. Ditën tjetër mbërritën lajme edhe më të këqija. Mbreti vendosi të dërgojë një ekspeditë në Tiranë.”³¹ Ekspedita ishte fatale. “Kapiten Sarri që u vendos në krye të 50 xhandarëve dhe 100 malësorëve katolikë”³² u gjend përpara një situatë të papëlqyer. “Vullnetarët malësor, të përpunuar natën prej propagandës shijakase refuzuan të niseshin, duke thënë “Na kena ardhur që të mbrojmë Vidin dhe jo të luftojmë”.³³ Pas kësaj ngjarjeje që në vetvete ishte një goditje e rëndë për pushtetin e Princit dhe qeverisë së tij, Vid-i është i detyruar të fusë në veprim anëtarë të K.N.K. dhe figura të njohura brenda vendit. “Vidi dërgoi Mehmet Pashë Drrallën, me flamur të bardhë në dorë, për armëpushim. Më vonë mbërritën në Shijak Komisioni i Kontrollit, ku delegati i Austrisë August Krali, gjeneral konsull, u mbajti një fjalim shqip kryengritësve”³⁴. Këtu nisi tatëpjeta e pashmangshme e rënies gjithnjë e më tepër e ndikimit të qeverisë.

²⁹ *Po aty*, f. 83.

³⁰ Teksti i deklaratës së Esatit ishte: “Detyrohem në fjalën time të oficerit të largohem prej Shqipërisë dhe të mos kthehem më atje, pa autorizim të nënshkruar personalisht prej madhërisë së Tij Mbretit. Detyrohem gjithashtu të mos marrë pjesë në çdo agjitacion të brendshëm dhe të jashtëm”. 20 Maj 1914. Nënshkruar: Esad Toptani. *AIH*, Fondi A-IV-66, shtojcë V, fl. 66.

³¹ H. D. Armstrong, *vep. e për.*, f. 59.

³² *Po aty*, f. 59-60.

³³ S. Vllamasi, *vep. e për.*, f. 66.

³⁴ *Po aty*. Mes të tjerash Krali iu drejtua kështu kryengritësve: “Babën që ju kërkoni nuk e përzunë shqiptarët, por e përzunë me luftë armiqtë tuaj serbët dhe grekërit. Ai u detyrua të ikë vetë nga Shqipëria. Këto gjëra që bëni ju janë budallallëqe, prandaj hiqni dorë se do të vinë serbët e do t’ju therrin të gjithëve”, f. 67.

Pozita e Vid-it përballë kryengritjes në Shqipërinë e Mesme

Shqipëria e Mesme ishte përfshirë nga vala e kryengritjes, e cila fillimisht dukej se nuk kishte ndonjë kërkesë të veçantë. Situatën e vështirë në të cilën ndodhej Vid-i, konsulli Pavllov ia paraqet në këtë mënyrë Ministrin të tij të Jashtëm: *“Gjendja e Princit është shumë e lëkundur. Rrëzimi i Esatit ka mundësi të qetësojë vendin dhe të forcojë pushtetin e Princit me të vetmin kusht: të ketë në dispozicion një fuqi të organizuar ushtarake dhe politike”*³⁵. Kërkesës së *“Turhan Pashës për një fuqi internacionale drejtuar Evropës, u refuzua”*³⁶. Gjendja politike në Shqipëri nuk linte shumë shpresa se mendimi i shfaqur nga diplomatë bullgar të mund të realizohej. *“Të ashtuquajturit nacionalistë të krishterë nga Jugu, janë patriotë të mirë, por pa ndonjë influencë në këtë vend klanesh”*³⁷. Por ajo që e rrënoi në mënyrë të pariparueshme personalitetin e Princit ishte data 23 maj. Armstrong, Buchberger dhe Vidi pranojnë se Aliotti ishte njeriu që i bindi të largoheshin nga pallati. Vidi dhe Armstrong kujtojnë se *“Aliotti erdhi në orën 3.00 të drekës dhe i shqetësuar i njoftoi se duhej të largohej pasi 8-10.000 vetë kryengritës po i afroreshin Durrësit”*³⁸. Vidi pranon se ka refuzuar, por *“kur mu lutën të gjithë ministrat e mij dhe ministri austriak, unë pranova”*³⁹. Armstrong shkon më tutje duke shtuar se *“si një goditje përfundimtare Aliotti mu hakërrua mua se, nëse nuk do t'i merrja seriozisht paralajmërimet e tij, më pas do të ishte shumë vonë.”*⁴⁰ Ndërsa Salleo duke ju referuar Aliottit shprehet se *“shpërngulja e Princit nga Pallati tek “Misuratta” ishte i motivuar nga kërkesa për të siguruar familjen”*.⁴¹ Fischer për këtë ngjarje ka këtë mendim: *“Duket se italianët kanë luajtur një rol të rëndësishëm, duke krijuar përshtypjen se forcat kryengritës ishin shumë më të mëdha se forcat e Princit dhe e këshilluan këtë të fundit të largohej në bordin e një anijeje italiane”*.⁴² Nëse Vid-i ishte i motivuar për të mbrojtur

³⁵ AIH, Fondi A-IV-271, Arkivi sekret. i Ambasadës Bullgare në Vjenë, Nr.2481, fl. 65.

³⁶ Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, Tiranë, 1998, f. 245.

³⁷ AIH, Fondi A-IV-271, Dok. të Ambasadës Bullgare në Vjenë, fl.60.

³⁸ *Po aty*, Fondi A-IV-66, V. Vidi, bur. i përm., f.15.

³⁹ H. D. Armstrong, *vep. e përm.*, f.62.

⁴⁰ *Po aty*, f.62.

⁴¹ F. Salleo, *vep. e përm.*, f.90.

⁴² B. Fischer, *vep. e përm.*, f.21.

familjen, a mund të kishte dërguar në anije vetëm familjen dhe vetë të hetonte nga afër gjendjen? Kjo ngjarje ka pikëpyetje të mëdha. A ishte real numri i kryengritësve dhe pse Aliotti ishte kaq i mirinformuar për gjendjen?

Aliotti, i cili ishte njeriu që nxiti më shumë ikjen e Princit është akuzuar nga S. Bej Vlora, i cili i referohet ditarit të Z. Sulioti “*burimi i kryengritjes ish në Legatën Italiane, komanda e rebelëve ish në dorën e baron Aliottit*”⁴³.

Në të njëjtin mendim bie edhe Buchberger, njëri prej këshilltarëve të Vidit. “*Në Shijak, afër Durrësit kishte shpërthyer një revoltë fshatarësh, që kërkonin largimin e mbretit protestan. E kurdisur prej xhonturqëve ajo, si kundër të gjitha aksioneve që drejtoheshin kundër mbretit, u përkrah me dashamirësi prej Aliottit*”⁴⁴. Nëse Vidi ra viktimë e një plani italian apo një manovre të zgjuar të baron Aliottit, kjo nuk mund të thuhet me siguri të plotë. Sidoqoftë, Aliotti gjeti një rast dhe e shfrytëzoi në mënyrë të përsosur, për të treguar se italianët ishin po aq të nevojshëm sa austro-hungarezët për Vidin. “*Agjentët italianë ishin përpjekur t’i jepnin lëvizjes një drejtim, i cili do ta favorizonte atë shtet. Kryengritësit me ndërgjegje ose pandërgjegje lozën lojën italiane*”⁴⁵. Ndërsa përsa i përket rolit të Austro-Hungarisë, Kondis ka mendimin se “*Austria dëshironte të përkrahte Princin, ajo ishte e detyruar ta përkrahte me mençuri për t’ju shmangur Luftës*”⁴⁶.

Parë në këtë këndvështrim mund të besohet se opinionet e Buchbergerit, Armstrong, S. Bej Vlorës, E. Bej Vlorës kishin brenda tyre pjesë të mëdha të së vërtetës përsa i përket politikës italiane në Shqipëri. Vidi pranoi të ikë pa e menduar gjatë se cilat ishin pasojat dhe cili do të qe qëndrimi i popullsisë dhe përkrahësve të tij. “*Prestigji i tij mori një goditje të fortë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropë, e madje në Austri u akuzua nga shtypi se iku nga sytë këmbët*”⁴⁷. Tashmë Vidi

⁴³ AIH, S. bej Vlora, *bur. i cit.*, fl. 54. S. bej. Vlora arrin në këtë përfundim pasi citon pjesë të ditarit të Z. Sulioti: “Nëpër sokak përveç italianëve tjetër njeri nuk shihej, në çdo anë ndihej nevoja e mbrojtjes së Italisë dhe vetëm flamuri i Italisë valonte”.

⁴⁴ “Studime historike”, nr. IV, viti 1972; K. Buchberger, *Vjetët e mia në Shqipëri*, f. 171.

⁴⁵ V. Kondis, *vep. e përm.*, f. 119.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ F. Salleo, *vep. e përm.*, f. 148.

gjendej para problemeve shumë të vështira, dhe me një gjendje morale e shpirtërore të goditur rëndë. Kryengritësit që siç duket kishin marrë zemër nga veprimi i Vidit, i ofruan këtij të fundit armëpushim. Kjo ishte një mundësi që ai të përballej me kryengritësit për të parë se çfarë kërkonin realisht *“Për çudinë e të gjithëve u paraqit kapiteni Sari, i cili ishte kapur nga rebelët në mëngjes në Shijak”*⁴⁸. Shumë shpejt u kuptua se çfarë kërkonin rebelët. *“Ata kërkonin një letër amnistie për të gjitha shkëljet në të kaluarën dhe premtonin të mos e sulmonin qytetin tani për tani. Mbreti formuloi një letër amnistie dhe ja dha Kapiten Sarit”*⁴⁹. Edhe vetë Vidi ishte i interesuar për të dekretuar një falje që do t’i jepte qetësi vendit. Ky armëpushim nuk zgjati shumë dhe anarkia u rikthye sërish.

Ndërthurja e rebelimit në Shqipërinë e Mesme me “çështjen epirote”

Në kushtet në të cilat ndodhej vendi, grekët e kishin shumë të lehtë (të përkrahur edhe nga KNK) t’i kërkonin qeverisë shqiptare ratifikimin e “Protokollit të Korfuzit”. *“Fuqitë e Mëdha” siç shkruan Kondis në të vërtetë ndonëse nuk e garantuan marrëveshjen (Protokollin e Korfuzit) e ratifikuan atë më 1 Qershor 1914*⁵⁰. Qeveria shqiptare dhe Vidi nuk e kishin thënë fjalën e tyre për këtë çështje. Kondis shkruan *“se qeveria pranonte “Protokollin e Korfuzit” me disa rezerva”*⁵¹. Marrëveshja jo vetëm që nuk u zbatua, por zjarri dhe terrori në Jug u ngritën në një shkallë më të lartë. Kjo që edhe një nga pasojat më të rënda që “kryengritësit antifeudal” nuk e morën asnjëherë parasysh. Ndërkaq kryengritësit kishin formuar tashmë komandën e tyre dhe bënë plane për të shtënë në dorë qytetet që ishin jashtë çdo kontrolli të qeverisë së Durrësit. *“Lëvizja rebele u organizua në Tiranë nga Arif Hiqmeti, ⁵² i cili*

⁴⁸ H. D. Armstrong, *vep. e përm.*, f. 66.

⁴⁹ *Po aty*. Ai kujton se “Sari i kishte thënë se në rast se nuk dekretohet amnistia rebelët do të vrisnin të gjithë robërit në duart e tyre”.

⁵⁰ V. Kondis, *vep. e përm.*, f.122.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² Për këtë figurë S. Vllamasi kujton: *“Me ardhjen e Vidit në Shqipëri, edhe në Dibër u krijua qeveria lokale me prefekt të qarkut Jusuf Hipen Agolli. Serbët donin të formonin një qeveri të tipit të Zografosit, që të përfshinte Dibrën e Matin, duke futur në dorë qafën e Murrës, atë të Bullit dhe Shkodrën e Lumnikun, që kishin një rëndësi të madhe strategjike. Pasiç, kryeministrit serb i duhej një vegël që ta*

punonte për hesap të Turkis. Dy bashkëpuntorët e tij më të ngushtë nga pikëpamja politike ishin Myftiu i Tiranës Musa Qazimi dhe Mustafa Ndroqi. Në këtë fazë vendimtare komandant i forcave rebele ishte Haxhi Qamili".⁵³ Ndërsa S. Vllamasi lidhur me këto ngjarje shkruan "Më 3 Qershor, para se të shkelej gjithë Shqipëria e Mesme, bëhet një mbledhje e këshillave në Shijak ku zgjidhet i pari Këshill i Përgjithshëm si vijon: kryetar Mustafa Ndroqi (esadist), nënkryetar Xhenabi Adili (xhon turk) major i ushtrisë turke, dhe komandant i përgjithshëm Qamil Haxhi Feza (turkoman elbasanas)"⁵⁴.

Ky bashkim i njerëzve pa ideal e princip, ishte fund e krye një vepër e atyre që kërkonin destabilizimin e Shqipërisë. Asnjë kërkesë tjetër përveç largimit të Vidit nuk pranohej, e përveç kësaj kërkohej të rikthehej regjimi osman ose një përfaqësues nga dera e Sulltanit.

Në këtë rast është e vështirë të kuptohej fillimisht se cila ishte aftësia e këtyre njerëzve, dhe sa larg mund të shkonin me veprimtarinë e tyre. Megjithatë një farë armëpushimi i dha kohë Vidit të mendonte se cila do të qe rruga më e mirë për të dalë nga kjo gjendje me sa më pak humbje dhe në të mirë të vendit. Ai shumë pak besonte në një mbështetje të fortë ushtarake nga jashtë. Kjo mbështetje mbetej vetëm në kuadrin e deklaratave. Gjithçka i mbetej Vidit dhe qeverisë së tij. Dukej se bisedimet me rebelët ishin të destinuara të dështonin pasi "kërkesat e tyre ishin bërë të papranueshme, sepse ato ngulnin këmbë që Mbreti të largohej nga vendi dhe në vend të tij të vihej një princ Mysliman".⁵⁵ Në këto kushte Vidi kërkoi "të përpunonte një plan të fuqishëm për fushatën, që në letër dukej shumë i mirë dhe që ndoshta do të funksiononte mirë n.q.se trupat tona do të kishin njerëz të përgatitur mirë dhe jo banditë të armatosur".⁵⁶ Kjo lëvizje e Vid-it kishte brenda saj një guxim të madh, por njëkohësisht edhe rrezikun për dështim.

Mbase një përcaktim të drejtë se sa një iniciativë e tillë mund të kishte sukses në gjendjen ku ishte Shqipëria, na e jep Princi Sturdza: "E vërteta asht, se çdo iniciativ konstruktive sot në Shqipëri, asht e dënueme

përdorte për këtë qëllim, të cilin e gjeti në personin e Arif Hiqmetit. Shqiptar prej Kumanove, një tip i zgjuar dhe aventurier i klasit të parë. Arif Hiqmeti në Dibër nuk gjeti as më të voglën përkrahje". S. Vllamasi, vep. e përm., f. 77.

⁵³ T. Zavalani, vep. e përm., f. 246.

⁵⁴ S. Vllamasi, vep. e përm., f. 68.

⁵⁵ H. D. Armstrong, vep. e përm., f. 74.

⁵⁶ Po aty.

të dështojë. Çfarë do rruge që të ndjek njeriu, fqinjët e afërm dhe të largët do ta bajnë që të mos ja dalë në krye”⁵⁷. Përkundër mendimeve dhe planit të Vidit për një sulm ushtarak, fatkeqësisht mbështetja e tij ushtarake ishin vetëm vullnetarët. Kjo forcë ushtarake sado e motivuar që të ishte, i mungonte eksperiencia dhe disiplina, kaq të nevojshme në fushën ushtarake. Kjo do të ishte që në fillim një nga pikat e dobëta të planit të Vidit, shto këtu materialin ushtarak dhe koordinimin e veprimeve. Forca ushtarake përbëhej nga vullnetarët e Preng Bib Dodës, Markagjonit, B. Currit dhe I. Boletinit. Natyrisht që vetë Vidi preferonte dhe shpresonte, ndonëse shumë pak, në mundësinë e një zgjidhjeje me anë bisedimesh. “E porositë të qendrojë në pozitat e veta, e të mos vej më përpara. Si të mbarojë afati që ju është dhënë kryengritësve, në sulmohet në befasi t’i gjegjet sulmit”⁵⁸. Për të zhvilluar bisedime me rebelët u dërgua koloneli Philips. Duke shkruajtur për takimin e kolonel Philips me kryengritësit, E. Durham shpjegon se: “Rebelët lajmëruan në Durrës se donin të flisnin me një përfaqësues anglez. Atëhere erdhi gjenerali Philips të takohej me ta”⁵⁹. Duke sjell në kujtesën e saj disa detaje “të bisedës mes parisë së kryengritësve dhe gjeneralit Philips”⁶⁰, të bënë përshtypje dhe krijohen dyshime të forta për përgatitjen e tyre të lartë politike. Ata jo vetëm që ishin shumë të qartë në kërkesat e tyre, por kishin edhe njohuri mjaft të sakta se çfarë ndodhte në politikën angleze. Mund të shprehet habia sesi këta njerëz që sipas Philips “as shqip nuk dinin të flisnin”⁶¹, të dinin sesi zhvillohej lufta politike në Angli. Ky fakt shpjegon më së miri jo vetëm qëllimin e vërtetë të rebelimit, por edhe cilët ishin ata që e udhëhiqnin këtë lëvizje në dobi të interesave të tyre. Lëvizja rebele jo vetëm po operonte me sukses në territorin e saj, por

⁵⁷ T. Zavalani, *vep. e përm.*, f. 246.

⁵⁸ *Arkivi Qendror i Shtetit* (më tej: *AQSh*), F. 50, fl.6. Telegram i Vilhemit (Mbret i Shqipërisë) drejtuar Preng Bib Dodës.

⁵⁹ Edith Durham, *20 vjet ngatërresa ballkanike*, f. 282.

⁶⁰ *Po aty*. Mes të tjerash Durham shkruan: “Njëri nga paria e rebelëve i tha gjeneralit Philips: Në Angli është një qeveri liberale. Shumë nga ju nuk e pranonin, por ky është vullneti i shumicës. Ne jemi shumica dhe duam një Princ mysliman”.

⁶¹ *Po aty*, f. 283. Më tej Durham shton: “Philips bëri një apel të fuqishëm të ndalonin këto luftime vëllavrasëse dhe të pranonin Vidin që kishte zgjedhur Evropa. Ai raportoi se turma dukej sikur e pranonte dhe i pëlqente të vinte në marrëveshje. Por të 5 kryetarët e huaj nuk donin”.

filloi edhe bashkëpunimin me bandat epirote. Kjo situatë vuri në pozitë të vështirë krahinat në jug dhe juglindje të vendit. Ky bashkëpunim e ka zanafillën që në pushtimin e Elbasanit. “Majori Shellën duke patur prova se Metropolit Gjermanos ishte nxitësi kyresor i revoltës (Puçit grek të Korçës 2 prill 1914-N.M) e arrestoi atë dhe anëtarë të këshillit të qytetit dhe i çoi në Elbasan. Pak më vonë përkrahësit e Esatit çliruan atë dhe të tjerët”⁶².

Një dëshmi interesante për këtë bashkëpunim japin edhe Vllamasi, Vlora dhe Kondis. Sipas këtij të fundit “Zografos urdhëroi pushtimin e Korçës sepse i frikësohëj faktit që trupat shqiptare me mungesë disipline të plotë do të pushtonin dhe plaçkitnin Korçën”⁶³. Më tej Kondis pohon se ka patur një marrëveshje me rebelët. “Vardha i urdhëruar nga Zografoja mori qytetin dhe kryengritësit e Shqipërisë së Mesme kërkuar marrëveshje me Vorio-epiriotët”⁶⁴. Vllamasi duke i bërë një analizë më të gjatë kësaj ngjarjeje nënvizon: “Për caktimin e kufirit greko-shqiptar emërohet nga ana rebele Qamil Feza Elbasani dhe nga ana epirote kapedan Vardha. Në bazë të marrëveshjes kufiri caktohet në Maliq, duke lënë në duart e grekëve, Korçën me rrethet, Devollin dhe Kolonjën”⁶⁵. Për koordinimin mes rebelëve dhe bandave “vorio-epiriote”, Vidi shkruan: “Karakteristike ishte një shkresë e rebelëve drejtuar qytetit të Beratit, në të cilën kyftohet të dorëzohet. Mes të tjerash thuhet: Ne bëjmë një punë të përbashkët me grekërit që marshojnë në Jug, me Triple-Ententin (Antanta-N.M) dhe Italinë”⁶⁶. Për të forcuar dyshimet e Vidi, për çështjen e Beratit, Kondis jep edhe një tjetër fakt: “Trupat autonomiste, pushtojnë Beratinë pa lejen e qeverisë autonome, duke u detyruar ta braktisin atë me urdhër të Ministrit Dhulis”⁶⁷. Në gusht të 1914 rebelët jo vetëm që po e intensifikonin veprimtarinë e tyre, por vepronin dhe në harmoni të plotë me bandat vorio-epiriote. “Më 8 gusht

⁶² AIH, Fondi A-IV-121, bur. i cit., fl. 63.

⁶³ Po aty, Fondi A-IV-63, bur. i cit., fl.124.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ S. Vllamasi, vep. e përm., f. 71.

⁶⁶ AIH, Fondi A-IV-66, V. Vidi, bur. i cit., fl.18. Më tej Vidi shton se “Kjo shkresë erdhi më 2 korrik në Durrës, dërguar prej magjistratit të Beratit, Ministrit të Brendëshëm”.

⁶⁷ V. Kondis, vep. e përm., f. 125.

bandat “epiriote pushtuan Korçën dhe Kolonjën. Rebelët myslimanë ishin në Pogradec, dhe nuk lëvizën as gishtin”⁶⁸.

Tentativat e fundit të Vid-it për të shuar rebelimin

Në fillim të qershorit deri më datën 15, gjithçka dukej se i ishte lënë rrjedhës së ngjarjeve. Durrësi ishte i shkëputur nga pjesa tjetër e vendit, ndërkohë që Vidi, ende përpunonte planin e tij për të qënë sa më i suksesshëm. Ndërsa përgatitjet dhe plani në letër ishin gati për t’u zbatuar, papritur rebelët sulmojnë Durrësin. Në këto kushte ka të ngjarë që veç hutimit të parë nga ky sulm i befasishëm, rol negativ të ketë luajtur edhe moskoordinimi i forcave të Vid-it. Megjithatë në këtë rast roli i oficerëve hollandez, e veçanërisht i kolonelit Tomsom ka qënë vendimtar. Në këtë betejë që mund të quhet edhe si prova e forcës, për herë të parë palët u përballën me njëra-tjetrën. Duke përshkruar këtë ngjarje në kujtimet e tij, S. Vllamasi shkruan: “*Afër të gdhirit, kryengritësit sulmuan nga Bishti i Pallës me 500-600 shijakas dhe nga Ura e Dajlanit me kavajas të komanduar nga Sheh Hamdi Shijaku. Fuqia qeveritare e priti sulmin me trimëri. Kryengritësit u thyen duke lënë shumë të vrarë. Në Gazha një kavajas kalon tinzisht Urën e Dajlanit dhe qëllon e vret kolonelin Tomson dhe Ajdin Dragën, vëllain e Nexhip Dragës*”⁶⁹.

Ndërsa sipas Salleos “*Princi Vid-i u rreshtua në vijën e zjarrit mes njerëzve të tij, ku u prit me entuziazëm. Koloneli Tompson u qëllua për vdekje në vijën e parë. “Thirjet e tij ushtrojnë një ndikim magjik” shkruante shtypi italian që s’mund të thuash se e donte, nga që gëzon simpatinë e njerëzve*”⁷⁰. Vrasja e kolonelit Tomson më shumë se humbja e një oficeri, ishte humbja e një komandanti të vendosur në luftë dhe me plan të qartë ushtarak. Pa mohuar aftësitë e oficerëve të tjerë, kjo qe një humbje, që për momentin do të ishte e vështirë të zëvendësohej. Nisur nga këto premisa, kryengritësit mund t’i kishin dhënë fund mbrojtjes së Durrësit “*por majori Hoelfsema mori komandën dhe futi në veprim artilerinë*”⁷¹.

⁶⁸ E. bej Vlora, *vep. e për.*, f. 97-98.

⁶⁹ S. Vllamasi, *vep. e për.*, f.67-68. Më herët, sipas autorit, “Në luftën e kodrave u vra kapiten Kamber Sejдини, patriot veteran dhe një nga oficerët më të mirë të Shqipërisë”.

⁷⁰ F. Salleo, *vep. e për.*, f. 101.

⁷¹ *Po aty.*

Të gjitha këto masa të përforcuara edhe “nga zbarkimi i njëmijë mirditorëve të dërguar nga Bib Doda dhe majorit Kroon, të nisur me ngut nga Shkodra për të zëvendësuar Thompson-in”⁷², shpëtuan Durrësin nga kryengritësit. Në këto rrethana të krijuara, Vidi nuk e humb toruan, por kërkon të ndërmarrë një sulm për t’i dhënë goditjen përfundimtare lëvizjes rebele. Suksesi i kërkuar nga Prici nuk erdhi. Ky dështim i sulmit tregoi edhe njëherë sesa larg koordinimit ishte fuqia mbrojtëse e Vidit. Për rrethanat e krijuara, kjo nuk mund të qe vetëm humbja e radhës, por një humbje që do të kushtonte shumë. Mbase këtu Aliotti ka të drejtë kur “i shkruan Romës më 18 qershor se: *Qeveria është e ligështuar dhe s’ka më asnjë mundësi të rivendos prestigjin e vet*”⁷³. Ndërsa Vidi mbyllet në Durrës, rebelët tashmë filluan një sulm në shkallë të gjerë, për të shtënë në dorë të gjitha territoret në Shqipërinë e Mesme. Sulmi i tyre u shoqërua me një terror dhe dhunë, veçanërisht mbi elementët nacionalistë. “*Në Berat u ekzekutuan tre patriotë: kapiten Baki Gjebrea, Hajredin Fratari dhe Ismail Klosi*”⁷⁴. Është e vështirë të mendohet se e gjithë kjo histeri të ishte vetëm një lëvizje agrare, apo aq më pak vrasjet të jenë kryer në luftim e sipër. Gjithçka qe e programuar. Nëse nipërit e Rrapo Hekalit u vranë në luftim e sipër, Baki Gjebrea, Hajrenin Fratari dhe Ismail Klosi, u ekzekutuan pa asnjë shkak. Pabesisht ishte vrarë edhe koloneli Tomson, ashtu sikundër këtë fat të keq e pati edhe djali i Sali Butkës, Gani Butka. “*Tradhëtisht u vra edhe Gani Butka i plagosur në tërheqje e sipër prej plumbave të ardhur nga një dritare në Pogradec*”⁷⁵. Sali Butka së bashku me Spiro Bellkamenin ishin simboli i qëndresës shqiptare ndaj shovinizmit grek. Ky ishte një ndëshkim i pamërituar për nacionalistët shqiptar. U bë e qartë se ata që e shihnin Vidin si pengesë apo kërkonin largimin e tij, po ia arrinin qëllimit. Në përpjekje për të dalë nga kjo gjendje e krijuar, Vidi i drejtohet atyre që e kishin sjellë në Shqipëri me aq besim e shpresë. “*Më 10 korrik i dorëzova një notë të gjithë përfaqësive të Fuqive të Mëdha. Në të përshkrova se Shqipëria do të kish një të ardhme më të lumtur, por se nuk qe e mundur, sapo vendimet e Londrës nuk respektoheshin. Po qe se Fuqitë e Mëdha nuk respektojnë vendimet e marra në Londër, atëherë zhvillimi i Shqipërisë si*

⁷² T. Zavalani, *vep. e përm.*, f. 248.

⁷³ F. Salleo, *vep. e përm.*, f. 102.

⁷⁴ S. Vllamasi, *vep. e përm.*, f. 71.

⁷⁵ *Po aty*, f. 68.

një shtet i rregullt do të qe i pamundur".⁷⁶ Kjo përpjekje e fundit e Vid-it nuk pati ndonjë rezultat të dukshëm dhe gjendja sa vinte e rëndohej. Vlora po përjetonte një situatë të tillë, përmasat e së cilës mund të quhesh pa frikë si katastrofë humanitare. Kjo gjendje e vështirë e detyroi delegatin e KNK-së, Harry Lamb t'i drejtohet Foreign Office me këto fjalë: *"kërkojë të largohem nga ky vend, për të mos mbajtur përgjegjësi morale për një popull që po shfaroset dhe unë s'mund të bëj dot gjë"*⁷⁷. Në aspektin diplomatik, përçapjet e tij nuk patën ndonjë efekt shumë të madh. Amstrong, siç shkruan ai vetë *"e kishte nxitur mbretin t'i kërkonte ndihmë Britanisë së Madhe, por se z. E. Grey kishte deklaruar se Britania e Madhe nuk do të dërgonte më trupa në Shqipëri"*⁷⁸. Por në realitet nuk ishte vetëm Britania e Madhe që nuk përkrahte një angazhim ushtarak në Shqipëri. *"Vidi kërkoi me ngulm huanë dhe trupa ndërkombëtare, kërkesë e përkrahur nga Fuqitë e Mëdha në Durrës. Qeveritë e Italisë, Anglisë dhe Gjermanisë nuk e përkrahën një gjë të tillë"*⁷⁹.

Pushtimi i Shqipërisë nga rebelë.

Largimi i Vid-it nga Shqipëria

Largimi i Vidit mund të quhet edhe fundi i një eksperimenti (nëse mund të shprehemi kështu) i një modeli europian për Shqipërinë. Përpara largimit të tij, Vidi u kujdes të kryente të gjitha detyrimet si ndaj përfaqësuesve diplomatik të mbetur në Durrës, ashtu edhe ndaj qeverisë dhe popullit shqiptar. *"Më 2 shtator mblodha ministrat dhe të tre anëtarët e pranishëm të K.N.K në Durrës, përfaqësues të Italisë, Francës dhe Austro-Hungarisë dhe iu luta në një fjalim që gjatë mungesës sime të përkohshme prej Shqipërisë, të merrnin në dorë qeverinë"*⁸⁰. Nëse ky veprim i Vidit ishte thjeshtë një lëvizje diplomatike për të treguar se ai nuk hiqte dorë nga fronti, apo se besonte se tre anëtarët e KNK mund të qeverisnin vendin, kjo është e vështirë për t'u analizuar. Më 3 shtator Vidi shpalli deklaratën drejtuar popullit shqiptar, ku njoftonte largimin e

⁷⁶ AIH, Fondi A-IV-66, V. Vidi, *bur. i cit.*, f. 17-18.

⁷⁷ M. Çami, *vep. e përm.*, f. 93.

⁷⁸ H. D. Amstrong, *vep. e përm.*, f. 106.

⁷⁹ AIH, Fondi A-IV-120, fl.18; R. Taushani, *Vidi dhe qëndrimi i Fuqive të Mëdha*.

⁸⁰ *Po aty*, Fondi A-IV-66, V. Vidi, *bur. i cit.*, fl. 24.

tij. Duke qënë se ky qe akti i fundit i mbretërimit të tij në Shqipëri, po e sjellim të plotë përmbajtjen e kësaj deklarate:

“Shqiptarë! Kur dërgata juaj më ofroi kurorën e Shqipërisë dhe më ftoi të drejtoja fatet e vendit tuaj, unë e pranova me gëzim dhe i frymëzuar nga një shpresë e madhe këtë ftesë të një populli heroik dhe fisnik për t’i ndihmuar në zhvillimin e vendit, në konsolidimin e lirisë së tij. Unë kam ardhur në Shqipëri për ta përmbushur së bashku me ju, këtë detyrë dhe që nga çasti i ardhjes e deri sot, jam përpjekur nderëshmërisht t’ju sigurojë Ju, një qeverisje të regullt dhe një qeveri të drejtë për të gjitha shtresat e popullit. Por mjerisht, trazirat dhe intrigat e penguan punën paqësore që ne kishim filluar.

*Njerëz të verbuar nga pasioni fanatik, u përpoqën ta dëmtojnë vendin tuaj, sepse ata nuk ndejnë as dashuri, as mirëkuptim për të. Lufta Botërore që shpërtheu ndërkaq, i vështirësoi edhe më tepër mundësitë e ekzistencës sonë. Për të bërë të mundur që popullit t’i rikthehet qetësia dhe mirëkuptimi, unë kam menduar për disa kohë të shkoj në vendet përëndimore. Gjatë kësaj kohë populli do të ketë mundësi të mendohet në qetësi dhe të gjejë rrugën e drejtë. Por ju siguroj se unë, kudo qofsha, afër apo larg Shqipërisë, do t’i vë të gjitha energjitë dhe mendjen time në shërbim të misionit të madh që i kemi vënë vetes, krijimit të një shteti të ri shqiptar. Derisa unë të kthehem në mes të popullit tim fisnik dhe heroik vendi do të qeveriset nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit”.*⁸¹

Ikja e Vidit i dha fund shpresës së shqiptarëve për një shtet pas vitesh dhe shekujsh ndarje dhe copëtimi. Pas largimit të tij, gjithëkush mund ta kishte të lehtë të thoshte se ai ishte i paaftë, nuk diti të qeverisë dhe më së fundi u largua. Kjo mund të ishte një përgjigje e thjeshtë, për një periudhë të shkurtër qeverisjeje. Në të vërtetë, rrënjët e dështimit ishin më të thella dhe se ato nuk mund t’i ngarkoheshin vetëm një personi. Vidi erdhi si një zgjedhje e Evropës dhe si i tillë ai do të mbarnte përsipër çdo kontradiktë apo mirëkuptim të vendeve europiane. Fuqitë evropiane nuk i dhanë të zgjedhurit të tyre as kushtin minimal për krijimin e një shteti: një territor të përcaktuar qartë dhe të pacënuar nga ushtri të huaja. Mbështetja financiare dhe ushtarake u harrua dhe kjo sillte vetvetiu dobësimin e pushtetit të Vidit. Modeli që kërkuan t’i imponojnë Fuqitë e Mëdha në Shqipëri, kishte të meta të mëdha. *“Plani i një qeverie i hartuar nga gjashtë Fuqitë e Mëdha tregonte paaftësi*

⁸¹ *Po aty*, fl. 83.

habitëse. Ishte një skenë pa asnjë përputhje, për një shtet me mospërputhje”⁸². Sikur të mos mjaftonte përçarja e brendshme, çështja e trupave greke jo vetëm që nuk u zgjidh, por u bë një nga faktorët më të rëndësishëm për destabilitetin e vendit. Në pikëpamje të brendshme, pavarësisht nga pritja entuziaste që ju bë Princit nga udhëheqësit e fuqishëm lokal, ata më shumë se nënshtrim ndaj pushtetit të tij, kërkonin të përshtatnin interesat e tyre me këtë qeverisje të re. Nëse analizojmë kushtet në të cilat ndodhej vendi, ajo ç’ka mund të ishte me efektivitet në Shqipëri, do të ishin masat e marra në bujqësi, tregti dhe artizanat. Pavarësisht këtyre masave që duhet të ishin marrë, ato nuk do të kishin efekt pa një rrjet rrugësh të afta për zhvillim. Qeveria nga ana e saj nuk tregoi një vullnet të plotë, apo të merrte përsipër të paktën hartimin e një programi të qartë ekonomik. Të gjitha këto do të vareshin nga ndihma evropiane, e cila mungoi. E vërteta ishte se evropianët nuk realizuan as minimumin e premtimeve. Në të kundërt, siç shprehet Buchberger “*Rivaliteti i dy fuqive (Austro-Hungarisë dhe Italisë) do të ishte fatal për fatet e vendit*”⁸³. Mund të ripohojmë, - siç thotë Salleo, ata mund të kenë dashur një Shqipëri vitale, e cila përkonte edhe me interesat e tyre në Adriatik, porse fryma e tyre e mosbesimit bëri të kundërtën. Në këtë klimë mosbesimi, lufte të brendshme, një qeverisje me territor të cunguar dhe pa legjitimitet të plotë, ditëve të eksperimentimit të Vidit në Shqipëri u erdhi fundi. Dëshira e Princit për të udhëhequr Shqipërinë, nuk gjeti atë mbështetje që ai do të dëshironte. Ai vetë ra viktimë (nëse mund të shprehemi kështu) edhe e mosnjohjes sa duhet të realitetit. Këshilltarët e tij më shumë ishin të prirur të vepronin në interes të atyre që i kishin emëruar dhe treguan paaftësi në momentet më kritike që kaloi sovranin e tyre. E parë në të gjithë veprimtarinë e tij dhe pa pretenduar se kjo analizë mund të quhet e plotë, mospërputhja e Vid-it u kushtëzua nga këto faktorë:

- 1- *Faktori i brendshëm*: Rolin më të madh këtu e luajti:
 - a) Veprimtaria e Esat Pashë Toptanit.
 - b) Mosfunksionimi i qeverisë.
 - c) Mungesa e qeverisjes në një territor të unifikuar.
 - d) Kryengritja e Shqipërisë së Mesme dhe pasojat e saj negative.
 - e) Moskoordinimi i veprimtarisë mes Qeverisë, Vid-it e K. N. K.

⁸² Fred George Williams, *Shqiptarët*, Tiranë, Argeta-LMG, 2003, f. 28.

⁸³ K. Buchberger, *vep. e përm.*, f. 170.

2- *Faktori i jashtëm:*

- a) Fuqitë e Mëdha që nuk treguan këmbëngulje në zbatim të vendimeve të Konferencës së Londrës.
- b) Presioni dhe terrori grek nëpërmjet bandave vorio-epirote.
- c) Mungesa e një force të armatosur evropiane që do të mund të siguronte kufijtë dhe rendin në vend.

Gjithsesi Shqipëria në ato vite pati mbështetjen e Fuqive Evropiane, të cilat të paktën në letër, por edhe në realitet provuan t'i jepnin legjitimitet shtetit të ri shqiptar si një formacion shtetëror, që deri në atë kohë nuk ishte njohur prej saj. Ky ishte edhe hapi më pozitiv për vendin tonë në atë periudhë.

S u m m a r y

THE POLITICAL SITUATION IN ALBANIA DURING
THE SPRING 1914

The author of this material is trying to analyze all internal and external factors of the movement which broke out in central Albania and is known as the "Revolt of Central Albania."

This movement which in its essence is treated as the peasantry revolt for its own rights, very soon changed evidently to an antinational movement. Through archival documents, memories, press documents of the period and authoritative editions in the field of history, we are trying to point out the internal and external factors which are:

1. *Internal factor*

- a. The activity of Esat Pashe Toptani;
- b. Impossibility and incapability of managing the created situation by the government of Princ Wied;
- c. Deficiency of a clear agrarian program, as one of the most important issues of the time.

2. *External factor*

- a. The Great Powers did not insist in implementation of their decisions

-
- b. The Greek pressure and terror exercised by “ vorio-epiriotë ” bands
 - c. The absence of a sufficient armed force to set the order and to defend the borders of the new Albanian state.

